

Traduction albanaise du formulaire "Information des parents et des adolescents sur les examens médicaux scolaires obligatoires" / Edition 2021

Njoftim për prindërit dhe të rinjtë mbi kontrollat e obliguara mjekësore shkollore

Të nderuar prindër dhe të rinjë

Në komunat e Kantonit të Bernit, në bazë të përcaktimeve ligjore, ekziston një shërbim mjekësor. Ky kontrollon gjendjet shëndetsore në kopshtet e shtetit dhe private dhe në shkolla gjatë shkollimit të obliguar.

Gjendja shëndetësore e fëmijëve kontrollohet në semestrin e I-rë të vitit të II-të të kopshtit(apo në rastet që nuk frekuentohet kopështi vitin e II-të, kontrolli bëhet në semestrin e I-rë të klasës të I-rë të shkollës fillore) përmes kontrollave (vizitave) mjekësore shkollore. Në anën tjetër të njoftimit gjeni të dhëna mbi vëllimin dhe përmbajtjen e kontrollave. Tek fëmijët, të cilët ndërrojnë shkollën kompensohet kontrollat e cila mungon.

Këto kontrollat mjekësore shkollore janë të detyrueshme. Këto mund të bëhen ose tek mjekja/mjeku i shkollës falas ose tek mjekja/mjeku i shtëpisë në shpenzime të prindërve. Pas bërjes së kontrollës mjekja/mjeku i shtëpisë duhet të lëshojë një vërtetim (shiqo anën e prapme të fletës) se kontrollat është kryer ose të shënojë terminin e parashikuar për kontrollim. **Një javë para kontrollës mjekësore shkollore** duhet që mjekja/mjeku i shkollës ta ketë këtë vërtetim. **Nëse në ditën kur është paraparë kontrollat mjekësore shkollore mjekja/mjeku i shkollës nuk e ka një vërtetim të tillë, ajo/ai do të bëjë kontrollën e detyrueshme mjekësore.**

Kontrollave mjekësore shkollore i takon edhe kontrollimi i vaksinimeve. Mjekja/mjeku i shkollës mund të bëjë vaksinimin e duhur me pëlqimin tuaj me shkrim. Përndryshe ju këshillohet që vaksinimi i duhur të bëhet tek mjekja/mejku i shtëpisë.

Nëse, me rastin e kontrollës mjekësore shkollore konstatohen çrregullime shëndetësore atëherë do të informoheni nga mjekja/mjeku i shkollës dhe luteni që të lajmëroheni tek mjekja/mjeku i shtëpisë për mjekim dhe shqyrtim. Shërbimi shkollor mjekësor nuk është përgjegjës për shqyrtim dhe mjekim.

Mjekja/mjeku i shkollës ju është në dispozicion për këshilla në të gjitha pyetjet të cilat kanë të bëjnë me problemet shëndetësore të fëmijës tuaj në lidhje me shkollën.

Date de l'examen par le médecin scolaire/Termini i parashikuar për kontrollën mjekësore shkollore nga mjekja/mjeku i shkollës:

Le médecin scolaire:
Mjekja/mjeku i shkollës:

Ky formular duhet të shpërndahet nëpërmjet mësuesëve të shkollës , të paktën një muaj para afatit të përcaktuar nga kontrolli mjekësor nga nëpër shkolla.



Vëllimi dhe përmbajtja e kontrollave të obliguara mjekësore shkollë sipas vendimit të 8 qershorit 1994 mbi shërbimin mjekësor shkollor (Ndryshimi nga 22 Maj 2013)

- Viti i II-të i kopshtit
- Konstatimi i historisë së sëmundjeve me prindër me anë të një pyetsori ose të një bisede;
 - Kontrollimi i vaksinave të kryera më parë, sipas nevojës propozimi për vaksinim ose vaksinimi;
 - Kontrollimi i syve dhe i të dëgjuarit (Audiometria është e detyrueshme);
 - Vlerësimi i gatishmërisë në shkollë në veçanti motorika, gjuha dhe zhvillimi;
 - Matja e gjatësisë dhe peshës.
- Viti i IV-ërt i shkollës fillore
- Konstatimi i historisë së sëmundjeve me prindër me anë të një pyetsori ose të një bisede;
 - Kontrollimi i vaksinave të kryera më parë, sipas nevojës propozimi për vaksinim ose vaksinimi;
 - Kontrollimi i syve dhe i të dëgjuarit (Audiometria është e detyrueshme);
 - Ekzaminim i sistemit të muskujve, veçanërisht skolioza, thellësia e gallganeve dhe qëndrimi;
 - Matja e gjatësisë dhe peshës.
- Viti i II-të i shkollës së mesme
- Bisedë me të rinjtë në lidhje me shëndetin dhe sjelljes së tyre kundrejt tij, duke plotësuar një pyetësor.
 - Kontrollimi i vaksinave të kryera më parë, sipas nevojës propozimi për vaksinim ose vaksinimi;
 - Kontrollimi i syve dhe i të dëgjuarit (Audiometria është e detyrueshme);
 - Matja e shtypjes së gjakut duke marrë parasysh shtypjen e lartë.
 - Matja e gjatësisë dhe peshës.

Sipas dëshirës dhe me pëlqimin e prindërve ose të rinjëve mjekja/mjeku i shkollës mund të bëjë kontrolla plotësuese fizike ose të këshilloj në rast problemesh.

..... ✂
Attestation du médecin de famille au sujet de l'examen scolaire qui doit être effectué comme décrit ci-dessus / Vërtetimi i mjekes/mjekut të shtëpisë mbi kontrollën mjekësore shkollë, e cila duhet të kryhet si është përshkruar më lartë: *

J'atteste par la présente

que j'ai procédé

que je procéderai le _____ à l'examen médical scolaire obligatoire au sens de l'ordonnance du 8 juin 1994 concernant le service médical scolaire sur la personne suivante / Me këtë vërtetoj se në bazë të vendimit të 8 qershorit 1994 lidhur me shërbimin mjekësor shkollor e kam bërë kontrollën e detyrueshme mjekësore shkollë tek ose do ta bëjë këtë me datën

Nom/Mbiemri: _____ Prénom/Emri: _____

Date de naissance/Ditëlindja: _____ Classe/Klasa: _____ Ecole/Shkolla: _____

Nom/prénom des parents//Mbiemri/Emri i prindërve: _____

Adresse/Rruga dhe Vendi: _____

Lieu et date/Vendi dhe data: _____

Tampon et signature du médecin de famille /Vula dhe nënshkrimi i mjekes/mjekut të shtëpisë:

*** Duhet t`i dorëzohet mjekes/mjekut të shkollës një javë para kontrollës mjekësore shkollë.**